

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarve F. J. dhe Q. H. të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkë kryerje të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31, të KP-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.132/2016 të datës 02.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, të akuzuarve dhe të dëmtuarit F. B., me datë 23.10.2017 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F. J., nga i ati F. dhe nëna R. e lindur A., i lindur me datë *data e lindjes...* në D., tani jeton në Prizren, rruga, pa numër, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.Q. H., nga i ati B. dhe nëna S. e lindur S., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin R., Komuna e R., tani jeton në Prizren, rruga ..., pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Se me datë 29.09.2014, rreth orës 19.05 minuta, në Prizren në rrugën, pa numër, në shtëpinë e të dëmtuarit F. B., në bashkë veprim, duke thyer kaluar apo depërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme, në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, hyjnë në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, ku me mjet të përshtatshëm e thyejnë xhamin e dritare së dhomës në katin për dhese, hyjnë brenda demolojnë gjërat e shtëpisë dhe pa marrë asgjë largohen nga vendi i ngjarjes,

Këso dore kanë kryer veprën penale në bashkë kryerje vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,41,43 par.1 pika 1.2 dhe 1.3, 45, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76, 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KP-ës, të akuzuarve ju shqipton:

Të akuzuarit të pare **F. J. :**

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 3 (tre) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 500 (pesëqind) Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse shuma e shqiptuar e dënimit nuk mund të ekzekutohet, e njejta do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 Euro 1 ditë burg, respektivisht 25 ditë burg.

Të akuzuarit të dytë Q. H.:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 3 (tre) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 500 (pesëqind) Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse shuma e shqiptuar e dënimit nuk mund të ekzekutohet, e njejta do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 Euro 1 ditë burg, respektivisht 25 ditë burg.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.132/2015 të datës 02.11.2016, kundër të akuzuarve F. J. dhe Q. H. të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkë kryerje të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31, të KP-së

Prokurori i shtetit Elfete Purova, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: qëndroj pranë aktakuzës PP.nr.132/2015 të datës 02.11.2016, kundër të akuzuarve F. J. dhe Q. H. të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkë kryerje të vjedhjes së rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31, të KP-së., dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin e sotëm në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprat

penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysht të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysht pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat ju vihen në barë

I dëmtuari F. B., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë si palë e dëmtuar nuk parashtrojë kërkesë pronësoro juridike, pasi që asgjë nuk më është marr nga shtëpia, dhe se sa i përket dëmit të shkaktuar me veprimet e të akuzuarve dhe ate thyerjes së derës dhe të xhamit, jemi marr vesh që së bashku me të akuzuarit, të paguajmë riparimin e saj.

I akuzuari i parë F. J., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale cila më vihet në barë, e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, pendohem thellë për veprën e kryer, nuk e di as vet se pse kemi vepruar në atë mënyrë, më vije keq për veprimet e kryera, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, po ashtu i kërkoj falje publike sot para gjykatës edhe të dëmtuarit F., andaj të gjitha të cekurat më lart, si dhe faktin e moshës sime në momentin e kryerjes së veprës penale, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

I akuzuari i dytë Q. H., në fjalën e tij përfundimtare deklaron, e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, edhe unë si F., nuk e di si i ndërmarra veprimet e cekura në aktakuzë. Më vije keq, i kërkoj falje publike sot para gjykatës këtu të dëmtuarit F., e po ashtu i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla. Të cekurat më lart, si dhe rrethanat tjera lehtësuese, siç është mosha ime njomë në momentin e kryerjes së veprës penale, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datë 29.09.2014, rreth orës 19.05 minuta, në Prizren në rrugën ..., pa numër, të akuzuarit në shtëpinë e të dëmtuarit F. B., në bashkë veprim, duke thyer kaluar apo depërtuar me forcë në hapësirat e mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme, në atë mënyrë që shfrytëzojnë momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, hyjnë në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit, ku me mjet të përshtatshëm e thyejnë xhamin e dritare së dhomës në katin përdhese, hyjnë brenda demolojnë gjërat e shtëpisë dhe pa marrë asgjë largohen nga vendi i ngjarjes,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprat penale të cilat ju vihen në barrë dhe që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPPK-ës dhe faktet që përmban aktakuza në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale dhe ate në bashkë kryerje të vjedhjes së

rëndë në tentativë nga neni 327 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31, të KP-së, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike për veprat penale që ju vihen në barë.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanë rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, sjellja korrekte e tyre pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tyre, gjer më tani të pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarve, moshën e të akuzuarve, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarve me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, shprehja e keqardhjes të akuzuarve për veprën penale të shkaktuar, si dhe sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata ju shqiptoi veç e veç dënimet dhe ate të akuzuarit të pare F. J. dënimin me burgim ë kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 3 (tre) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi,nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe denim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro, si dhe të akuzuarit të dytë Q. H. i shqipton dënimin me burgim ë kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 3 (tre) viteve nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi,nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe denim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro,duke menduar se dënimi i shqiptuar ju përgjigjet shkallës së përgjegjësive të tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2382/2016 të datës 23.10.2017

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.